

## Çfarë duhet të bëj në rast ndërprerjeje të rrymës elektrike?

- Fikni manualisht këto pajisje: plitkat e syprinës, hekurat e hekurosjes, ngrohëset elektrike, trapanët elektrikë, sharrat me korrent, fshesat me korrent, etj. Kujdes: nëse këto nuk hiqen nga priza ose nuk fikën do të ndizen sapo të rikthehet rryma elektrike, gjë që mund të jetë e rrezikshme!
- Kontrolloni nëse fqinjët tuaj gjithashtu janë prekur nga ndërprerja e rrymës elektrike. Nëse ndërprerja e rrymës elektrike prek shumë shtëpi, kontaktoni shërbimin e urgjencës së BKW në numrin 0844 121 175
- Nëse fqinjët tuaj ende kanë rrymë elektrike:
  1. Kontrolloni siguresat dhe ndërprerësin e qarkut,
  2. Kontaktoni me administratorin ose me elektrikistin e ndërtesës tuaj.
- Informoni njerëzit e moshuar dhe fëmijët për ndërprerjen e rrymës elektrike.
- Mbani frigoriferin tuaj të mbyllur për ta ndihmuar të qëndrojë i ftohtë.
- Nëse ndërprerja e rrymës elektrike zgjat më shumë se 12 orë, flakni çdo artikull në frigorifer për arsye sigurie ushqimore.
- Sapo të rikthehet rryma elektrike, kontrolloni që asnjë nga pajisjet tuaja nuk ka rrezik të shkaktojë dëme (p.sh. plitka e syprinës).